



## KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

### NJOFTIM

#### PËR

#### SHPALLJEN E PROCEDURËS SË NGRITJES NË DETYRË NË GJYKATËN E APELIT SHKODËR DHE NË GJYKATËN E APELIT GJIROKASTËR, PËR POZICIONE TË LIRA NË FUSHËN E TË DREJTËS CIVILE

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në Mbledhjen Plenare të datës 10.09.2020, ka vendosur:

- *rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Shkodër, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile;*
- *rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Gjirokastër, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile.*

Procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Shkodër dhe në Gjykatën e Apelit Gjirokastër, gjithsej për dy pozicione të lira, janë rihapur respektivisht me Vendimet nr.298 dhe nr.300, datë 10.09.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Me këto vendime Këshilli i Lartë Gjyqësor ka *shpallur kërkesën për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve që plotësojnë kriteret ligjore për ngritjen në detyrë në gjykatën e shkallës së dytë.*

#### Këshilli i Lartë Gjyqësor fton:

Çdo gjyqtar që është në një pozicion në një gjykatë të shkallës së parë ose në një pozicion të komanduar, i cili plotëson kriteret ligjore të ngritjes në detyrë në gjykatën e shkallës së dytë, për të marrë pjesë në këto procedura ngritjeje në detyrë dhe të paraqesë pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor dokumentacionin e nevojshëm të përcaktuar në vendimet e sipërcituara të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si dhe të pasqyruar edhe më poshtë.

Kriteret ligjore që duhet të plotësojë kandidati për t'u ngritur në detyrë në gjykatën e shkallës së dytë, në një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile, përcaktohen në pikën 3, të nenit 8, në pikën 4, të nenit 47, si dhe në pikat 7 dhe 8, të nenit 48, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si më poshtë:

- a) Kandidati duhet të ketë ushtruar ushtruar funksionin jo më pak se shtatë vjet në shkallën e parë, nga të cilat të paktën pesë vjet në fushën e së drejtës civile, duke përfshirë edhe përvojën si magjistrat i komanduar;
- b) Kandidati duhet të kalojë me sukses procesin e verifikimit të pasurisë dhe të figurës, sipas Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 75, datë 23.05.2019, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”;
- c) Kandidati duhet të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
- ç) Kandidati duhet të mos jetë në situatën e papajtueshmërisë ambientale sipas përcaktimeve të pikës 3, të nenit 8, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Plotësimi i kritereve të kandidimit do të verifikohet sipas kërkesave dhe procedurës së përcaktuar në vendimet e sipërcituara të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

#### **Në momentin e aplikimit kandidati duhet të paraqesë këto dokumente:**

- a) Kërkesën për shprehjen e interesit për të kandiduar për pozicionin e lirë të shpallur, duke e identifikuar atë përmes numrit të vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor;
- b) Jetëshkrimin, me të dhënat e plota të kontaktit (numër telefoni/e-mail);
- c) Fotokopje të kartës së identitetit;
- ç) Vetëdeklarim për mospasjen masë disiplinore në fuqi, sipas formularit bashkëlidhur këtij vendimi;
- d) Vetëdeklarim për mosqenien në situatën e papajtueshmërisë ambientale sipas përcaktimeve të pikës 3, të nenit 8, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, sipas formularit bashkëlidhur këtij vendimi.

**Afat i paraqitjes së kërkesës me dokumentacionin shoqërues, për secilin nga pozicionet e lira, është është dy javë nga dita e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, të njoftimit për rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë. - Ky afat përfundon më datë 24.09.2020.**

**Dokumentacioni i aplikimit duhet të dorëzohet nga kandidati në Zyrën e Protokollit pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, në adresën Bulevardi “Zog I”, Tiranë.**

Pas përfundimit të afatit të kandidimit, lista e kandidatëve për secilin nga pozicionet e lira do të publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**Të gjithë të interesuarit për më tepër informacion lidhur me procedurat e kandidimit mund të vizitojnë faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor, duke u konsultuar me Vendimet e tij nr.298 dhe nr.300, datë 02.07.2020.**

**Kujdes:**

Në zbatim të pikës 6, të nenit 48, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar:

- Në procedurat e ngritjes në detyrë në një gjykatë më të lartë ose të specializuar mund të kandidojë çdo gjyqtar që plotëson kriteret ligjore, pavarësisht faktit nëse ka kandiduar në procedura të mëparshme ngritjeje në detyrë.
- Në çdo rast, kandidati nuk mund të kandidojë në më shumë se tre pozicione të lira që janë në proces, pavarësisht kohës së shpalljes së tyre, qenies së tyre në të njëjtën gjykatë apo në të njëjtën fushë të së drejtës.
- Në rast të kandidimit në më shumë se tre pozicione të lira në proces, kandidati duhet të rikonsiderojë kandidimet e tij, për të përcaktuar tre pozicionet për të cilat vijon kandidimin. Mospërcaktimi i tyre nga vetë kandidati, passjell identifikimin e vullnetit të tij në bazë të kohës së kandidimeve, duke filluar nga ai i bërrë më parë ose në rastin e shumë kandidimeve në të njëjtën kohë, në bazë të radhës kronologjike të pozicioneve të shpallura, duke filluar nga ai i shpallur më parë.
- Kandidimi për një pozicion të lirë për të cilin procedura e ngritjes në detyrë është finalizuar/përmbyllur dhe kandidimi i tërhequr, nuk llogariten si kandidime për efekt të të drejtës së kandidimit në jo më shumë se tre pozicione të lira.

**Ky njoftim është publikuar më datë 10.09.2020.**